

	KOMENTE	FO-ÇRT-011
	ver. 1.2	faqe 1 nga 4

19.11.2025

Komente lidhur me Rregullën për Mekanizmin mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme

Dispozita	Referenca	Komentet
Viti Relevant	Neni 2.1.12	A është vit kalendarik, tarifar, apo periudhë 12 muajshe? Të definohet qartë ose të fshihet fjala Relevant .
1 Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme me skema mbështetëse duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Furnizuesit të tyre për energjinë elektrike të tërhequr nga rrjeti. Ndërsa, për energjinë elektrike të tepërt të futur në rrjet, duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.	Neni 5.1.	Vetëkonsumatorët nuk duhet të jenë pjesë e grupit balancues të OER as “për energjinë e tepërt”. Kjo është në kundërshtim me Nenin 28 paragrafin 2.5 të Ligjit BRE ku shkruhet që: 2.5. lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet, sipas një skeme mbështetëse të miratuar nga Rregullatori, ose lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet sipas kushteve të dakorduara reciprokisht në lidhje me furnizimin dhe injektimin e energjisë elektrike Duke implikuar kështu në mënyrë të drejtëpërdrejtë që vetëkonsumatorët të jenë pjesë e grupit balancuese të Furnizuesit. Një obligim i tillë për OER është i papranueshëm. Kompensimi i Vetë-konsumatorëve duhet të bëhet përmes Furnizuesve të tyre (në pajtim me Nenin 28 paragrafin 2.5 të Ligjit BRE duke nxitur kështu aktivitetet e tregut të lirë përmes kontaktimit të dakordueshëm të Vetë – Konsumatorëve me Furnizuesit.

		Ky propozim: 1. I kufizon (ose i ndalon) kontratat bilaterale të dakorduara lirshëm ndërmjet Vetë – konsumatorëve dhe Furnizuesve duke kufizuar kështu zhvillimin e tregut (në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin BRE). 2. E bën OER “single buyer” duke kufizuar konkurrencën, 3. rrit joefikasitetin duke krijuar monopol të paarsyeshëm dhe të panevojshëm, 4. ekspozon financiarisht KOSTT-in duke rrezikuar kështu operimin e KOSTT 5. E rritë koston administrative të KOSTT e me këtë implikon rritjen e tarifave. 6. – Implikon kërkesa të reja të paparashikuara dhe të panevojshme të shërbimeve të teknologjisë informative në KOSTT. 7. Rritë kostot e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme. 8. Rritë pasaktësinë e parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
1.1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme është Pala Përgjegjëse Balancuese për të gjithë energjinë elektrike të futur në rrjet nga Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme që marrin pjesë në skemat mbështetëse për Vetë-konsumimin e Energjisë së Ripërtërishme, dhe duhet të paraqesë nominime dhe përditësime në përputhje me Rregullat e Tregut.	Neni 5	Nominimi dhe përditësimi i nominimeve për energjinë elektrike të futur në rrjet nga Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme paraqet vështirësi operacionale për OER dhe kosto shtesë për fondin BRE për shkak të pasaktësisë së lartë në parashikim e prodhimit të Vetë-konsumatorëve. Kjo për shkak të paqëndrueshmërisë së lartë prodhimit dhe shpërndarjes gjeografike të tyre, mungesës së modeleve të avancuara

		meteorologjike dhe algoritmeve statistikore për parashikim të saktë të prodhimit, mungesës së matjeve në kohë reale dhe sistemeve të integruara IT për komunikim me operatorin e sistemit (TSO/DSO) lidhur me përditësimin e nominimeve, jolikuditetit të tregut të organizuar etj. Zhvillimi i sistemeve IT, sigurimi i modeleve të avancuara meteorologjike dhe algoritmeve statistikore për parashikim të saktë, trajnimi i stafit dhe mirëmbajtja e proceseve të nominimit etj., paraqesin kosto të konsiderueshme për Fondin BRE dhe vështirësi për OER në mbulimin e këtyre shpenzimeve. Gjithashtu mungesa e një tregu të organizuar likuid paraqet sfida shtesë për OER të shesë energjinë e tepërt të Vetë-konsumatorëve.
2.2 Informacioni i ndjeshëm komercial i marrë nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme gjatë operacioneve të tij të mos shkëmbehet me Operatorin e Tregut, përveç rasteve kur kërkohet për Operatorin e Tregut në ekzekutimin e mandatit të tij;	Neni 7.	Ky paragraf është i pamundshëm të zbatohet.
Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të përcaktojë Tarifat e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme në mënyrë të tillë që, brenda çdo Viti Relevant, të ardhurat që pret të fitojë nga tarifa të jenë të barabarta me Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme të miratuar nga Rregullatori	Neni 8. 1	Të ndryshohet pjesa e tekstit të jenë të barabarta me të jenë sa më afër që është e mundshme të barabarta
1.1 Të ardhurat nga shitjet e energjisë elektrike të blera nga Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme (BRE) nën Mbështetje, të cilët janë mbështetur bazuar në një Tarifë	Neni 12.1.1	Nga paragrafi të fshihet pjesa: ose energji elektrike të blerë përmes Skemës Mbështetëse të Vetë Konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme në Tregun

nxitëse (Feed-in), PPA ose energji elektrike të blerë përmes Skemës Mbështetëse të VetëKonsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme në Tregun e Organizuar;		
Operatori i Energjisë së Ripërtërishme është Pala Përgjegjëse Balancuese për të gjithë energjinë elektrike të futur në rrjet nga Vetëkonsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme që marrin pjesë në skemat mbështetëse për Vetë-konsumimin e Energjisë së Ripërtërishme, dhe duhet të paraqesë nominime dhe përditësime në përputhje me Rregullat e Tregut	Neni 5.1.1	Kjo është në kundërshtim me Nenin 28 paragrafin 2.5 të Ligjit BRE.
Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të zbatojë metoda të përshtatshme për ndarje të llogarive për të siguruar që	Neni 7	KOSTT sh. a. përgatitë Pasqyrat Financiare për qëllime të veçanta të Rregullatorit të cilat prezantojnë të dhënat e ndara sipas dy Licencave i cili auditohet çdo vit dhe për këtë qëllim mendojmë se ky raport mund të shërbej edhe për Operatorin e BRE-ve duke i ndarë shpenzimet dhe të hyrat ashtu siç janë ndarë deri më tani bazuar në Licenca.

Përgatitur nga: KOSTT

Komentim në lidhje me përfshirjen e Vetë-Konsumatorëve në grupin balancues të Operatorit të Energjisë së Ripërtësishme.

Neni 5.1.1. Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtësishme me skema mbështetëse duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Furnizuesit të tyre për energjinë elektrike të tërhequr nga rrjeti. Ndërsa, për energjinë elektrike të tepërt të futur në rrjet, duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Operatorit të Energjisë së Ripërtësishme.

Koment:

Vetëkonsumatorët nuk duhet të jenë pjesë e grupit balancues të OER as “**për energjinë e tepërt**”. Kjo është në kundërshtim me kushtet se si një konsumatorë fundor bëhet Vetë-Konsumator sipas Nenit 28 paragrafin 2.5 të Ligjit BRE ku për Vetë-Konsumatorët shkruan që:

2.5. lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet, sipas një skeme mbështetëse të miratuar nga Rregullatori, ose lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet sipas kushteve të dakorduara reciprokisht në lidhje me furnizimin dhe injektimin e energjisë elektrike

duke implikuar kështu në mënyrë të drejtëpërdrejtë që vetëkonsumatorët të jenë pjesë e grupit balancues të Furnizuesit.

Kompensimi i Vetë-konsumatorëve duhet të bëhet përmes Furnizuesve të tyre (në pajtim me Nenin 28 paragrafin 2.5 të Ligjit BRE duke nxitur kështu aktivitetet e tregut të lirë përmes kontraktimit të dakordueshëm të Vetë – Konsumatorëve me Furnizuesit).

Një obligim i tillë për OER është i dëmshëm sidomos për zhvillimin e tregut me pakicë edhe ashtu të munguar jashtëzakonisht shumë në Kosovë.

Ky propozim:

1. I kufizon (ose i ndalon) kontratat bilaterale të dakorduara lirshëm ndërmjet Vetë – konsumatorëve dhe Furnizuesve duke kufizuar kështu zhvillimin e tregut (në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me ligjin BRE dhe me ligjislacionin tjetër bazik).
2. E bën Operatorin e Energjisë së Ripërtësishme “Single Buyer” duke kufizuar konkurrencën,
3. Rrit joefikasitetin duke krijuar monopol të paarsyeshëm dhe të panevojshëm,
4. Ekspozon financiarisht KOSTT-in duke rrezikuar krejtë paarsyeshëm operimin e KOSTT,
5. E rritë koston administrative të KOSTT e me këtë implikon rritjen e paarsyeshme të tarifave.
6. Implikon kërkesa të reja dhe të paparashikuara dhe të panevojshme të shërbimeve të teknologjisë informative në KOSTT.

Shpresoj që kjo kërkesë e imja do të merret parasysh dhe neni Neni 5.1.1 të ndryshohet.

Sherif Dedaqi

Menaxher i Sektorit të Barazimit Përfundimtar
në Operatorin në KOSTT Sh.A

Prishtinë, 19.11.2025